



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE
NR.RREGJ.THEM.1473
DATA E ARDHJES 23.10.2020

NR.1473 VENDIMI
DATA 24.10.2020

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORE, E PERBERE NGA:

HERILA ÇELA – GJYQTARE

Sot me date 24.10.2020, perfundoi, çeshtjen penale Nr.1473 date 23.10.2020, qe i perket :

KERKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlore, perfaqesuar ne seance nga
Prokuror [REDACTED]

OBJEKTI: Kërkohet caktimi i masës së sigurimit pasurore të sekuestros preventive të parashikuar nga neni 274 të K.Pr.Penale, në kuadër të procedimit penal nr. 1042 të vitit 2017, mbi pasuritë e mëposhtme:

1. Të pasurisë së paluajtshme apartament tipi A-8, në katin e pestë nga toka dhe me sipërfaqe 77 m², e blerë nga shtetasja [REDACTED] përmes kontratës së kaparit nr. 1239 rep dhe nr. 463 kol, datë 13/07/2005, e lidhur ndërmjet shoqërisë “Alliaj” sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [REDACTED] në cilësinë e blerësit të ardhshëm, apartament i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga subjekti [REDACTED] sh.p.k, në lagjen “10 Korriku”, Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.
2. Të pasurisë së paluajtshme apartament tipi A-8, shkalla e dytë, i përbërë nga “1+1”, në katin e katërt nga toka e banesës dhe me sipërfaqe 77 m², i blerë nga shtetasja [REDACTED] përmes kontratës së kaparit nr. 1240 rep dhe nr. 464 kol, datë 13/07/2005, e lidhur ndërmjet shoqërisë [REDACTED] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [REDACTED] në cilësinë e blerësit të ardhshëm, apartament i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga subjekti [REDACTED] sh.p.k, në lagjen “10 Korriku”, Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.
3. Të pasurisë së paluajtshme dyqani nr. 1, me sipërfaqe 48.8 m² + 7.4 m² verandë, i pozicionuar në krahun veri-lindor të banesës, i blerë nga shtetasja [REDACTED] përmes kontratës së kaparit nr. 710 rep dhe nr. 393 kol, datë 11/05/2006, e lidhur ndërmjet shoqërisë [REDACTED] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [REDACTED] në cilësinë e blerësit të ardhshëm, dyqan i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga

subjekti [redacted] sh.p.k, në lagjen "10 Korriku", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.

4. Të pasurisë së paluajjtshme dyqan nr. 4A, me sipërfaqe 17 m², i pozicionuar në krahun perëndimor të banesës, i blerë nga shtetasja [redacted] përmes kontratës së kaparit nr. 710 rep dhe nr. 393 kol, datë 11/05/2006, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [redacted], në cilësinë e blerësit të ardhshëm, dyqan i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga subjekti [redacted] sh.p.k, në lagjen "10 Korriku", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.
5. Të pasurisë së paluajjtshme apartament që ndodhet në Linzë, Tiranë, shkalla 3, kati V, ap 14, me sipërfaqe 81.3 m², ZK 2460, me numër pasurie 192/43+3-14, vol 30, faqe 112, i blerë nga shtetasit [redacted] përmes kontratës së shitjes nr. 1239 rep dhe nr. 300 kol, datë 24/11/2014, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasve [redacted] e [redacted] në cilësinë e palës blerëse.
6. Të pasurisë së paluajjtshme me sipërfaqe ndërtimi 175 m² dhe me sipërfaqe të zënë 400 m², të deklaruar për legalizim më datën 17/07/2006 nga shtetasit [redacted].
7. Të pasurisë së luajjtshme e llojit automjet tip "Renault", vit prodhimi 1998, me targa [redacted] regjistruar në emër të shtetasve [redacted] dhe [redacted].
8. Të shumës prej 1.783.070 lekë lekë, të depozituara në Raiffeisen Bank, në llogarinë nr. 0030377866, në emër të shtetasit [redacted].

BAZA LIGJORE: Neni 36 i Kodit Penal, si dhe neni 274 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi shqyrtoi kërkesën analizoi në teresi ceshtjen dhe provat e paraqitura, në teresi;

VEREN

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, ka regjistruar procedimin penal nr. 1042 datë 28/06/2017, për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e materialeve referuese të ardhura nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë. Më datën 19.10.2020, në regjistrat e njoftimit të veprave penale është shënuar emri i shtetasit [redacted] si personi që i atribuohet kryerja e veprës penale të parashikuar nga neni 287/1 të Kodit Penal. Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera në lidhje me këtë procedim penal ka rezultuar se:

Shtetasi [redacted] alias [redacted], datëlindjes 17/06/1978 është dënuar me vendimin nr. 2028/2003 të Gjykatës Pesë Anëtarëshc të Krimeve të Rënda Athinë, për veprën penale të blerjes, posedimit, magazinimit dhe shitjes së lëndës

narkotike nga toksiokoman, me 5 (pesë) vite burgim. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se:

"Në mesnatën e datës 23-24/01/1999 është arrestuar nga oficerë të nën Drejtorisë së Luftës Kundër Trafikimit të lëndëve narkotike, shtetasi shqiptar (dhe një patriot i të akuzuarit) [redacted] për posedim të lëndës narkotike.

Menjëherë pas arrestimit të tij ai pranoi propozimin përkatës të shërbimit të lartëpërmendur, e cila kishte informacion për trafikimin e lëndës narkotike prej të akuzuarit, që të bashkëpunojë me të për arrestimin dhe të trafikantëve të tjerë të lëndës narkotike. Kështu, ra dakort shtetasi [redacted] të sjellë në kontakt dëshmitarin [redacted] (oficer të policisë së luftës kundër trafikimit të lëndës narkotike), si blerës kandidat i një sasi lënde narkotike, me të akuzuarin me qëllim që të kryhet arrestimi i këtij të fundit nga organet policore.

Realisht pas bisedës telefonike që [redacted] kishte me të akuzuarin u mbyll takimi i supozuar për në orën 01:00 të datës 24/01/1999 në një kafeteri të sheshit Koliatsou. Ky takim u krye në prezencë të shtetasit Piero Pano dhe u ra dakort që i akuzuari t'i shesë blerësit të mundshëm [redacted] 45 gram heroinë në shkëmbim të çmimit 5.000 dhrami për gram. Theksohet se gjuha që komunikonin këta persona ishte gjuha greke, pas pretendimit të oficerit të policisë [redacted].

Por përfundimisht shitja e kësaj sasi lënde narkotike nuk u krye për arsye të pavarura nga dëshira e të akuzuarit dhe konkretisht pas rënies dakort të marrëveshjes së mësipërme ai erdhi me një automjet me targa [redacted] në banesën që gjendet në adresën rruga [redacted] numër [redacted] afër sheshit [redacted] me qëllim që të marrë prej andej sasinë e mësipërme të lëndës narkotike dhe ta dorëzojë atë në vazhdim tek blerësi i më lartë përmendur, gjatë daljes nga shtëpia e tij rreth orës 01:15, ai u arrestuar pas urdhrit të oficerit të policisë, duke poseduar sasinë prej 45 gram heroinë.

Në vazhdim rezultoi se i lartpërmenduri i akuzuar posedonte në këtë shtëpi të braktisur sasi lënde narkotike.

Ai posedonte

- a) me 24/01/1999 dhe rreth orës 01.25 sasinë prej 377 gram heroinë dhe 242 gram kokainë,
- b) më 20/01/1999 posedonte sasinë prej 500 gram heroinë, c) më 23/01/1999 posedonte sasinë prej 100 gram kokainë.

Të gjithë këtë sasi lënde narkotike të llojit heroinë dhe kokainë që i akuzuari e kishte magazinuar në shtëpinë e lartë përmendur të braktisur, i posedonte me qëllim që t'i tregtonte dhe për lehtësim të këtij qëllimi ai përdorte edhe automjetin me targa [redacted], i cili i përkiste shtetasit [redacted] i biri i Georgiou, të cilin ai e kishte blerë më 04/06/1997 me mbajtje të pronësisë së tij dhe shtetasi i lart përmendur nuk kishte dijeni se automjeti i tij përdorej për vepra penale që kanë lidhje me trafikimin e lëndës narkotike.

Më tej, u vërtetua se i akuzuari në Athinë, në periudhë kohore të pa përcaktuar, gjithësesi nga gjashtëmuji e deri në arrestimin e tij, ka blerë nga person i panjohur, sasi lënde narkotike të llojit heroinë dhe kokainë, të paktën 922 gram heroinë dhe 342 gram kokainë, kundrejt një çmimi apo transaksioni tjetër me qëllim tregtimin e saj.

Gjithashtu, u vërtetua se në Athinë, më shumë se një herë, akte që përbëjnë përsëritje të të njëjtit veprim kriminal, në periudhë kohore që nuk është përcaktuar por brenda gjashtëmujorit e deri në arrestimin e tij, ai ka shitur dhe tregtuar sasi lënde narkotike të paktën 500 gram heroinë dhe 100 gram kokainë kundrejt një çmimi të paditur apo transaksioni tjetër, në persona të panjohur, ndërsa siç edhe u shënua ai tentoi të shiste më 24/01/1999 sasinë e lëndës narkotike 45 gram heroinë tek dëshmitari oficeri i policisë”.

Mbi të dhënat e mësipërme gjykata e ka shpallur fajtor shtetasin [redacted] alias [redacted] i datëlindjes 17/06/1978 për: “Në vendet dhe kohën e mëposhtme, pasi kishte përdorur lëndë narkotike dhe i pamundur ta eliminojë atë me fuqinë e tij, me dëshirë dhe me më shumë veprime kreu më shumë krime që parashikohen dhe dënohen nga ligji me heqje të lirisë me dënimin, më konkretisht:

1. Në Athinë dhe në një periudhë kohore që nuk është përcaktuar, por nga një gjashtëmujor të paktën dhe deri në arrestimin e tij ka blerë nga persona të panjohur sasi lënde narkotike të llojit heroinë dhe kokainë, të paktën 922 gram heroinë dhe 342 gram kokainë kundrejt një çmimi të panjohur apo transaksioni tjetër me qëllim tregtimin e saj.
2. Në Athinë a) më datë 24/01/1999 dhe rreth orës 01:12 në adresën rruga [redacted] në sheshin [redacted] posedonte sasinë e lëndës narkotike 45 gram të llojit heroinë, b) më datë 24/01/1999 dhe rreth orës 01:12, posedonte në banesën e tij në ad [redacted] në lëndës narkotike 377 gram të llojit heroinë dhe 242 gram lëndë narkotike të llojit kokainë, c) më datë 20/01/1999 posedonte në banesën e tij në adresën rruga [redacted] sasinë e lëndës narkotike prej 500 gram të llojit heroinë dhe më datë 23/01/1999 në të njëjtën banesë sasinë e lëndës narkotike prej 100 gram të llojit kokainë. Sasinë e mësipërme ai e posedonte me synim tregtimin e saj dhe për lehtësimin e kësaj procedure ai përdorte automjetin me targa [redacted] të markës Hyundai.
3. Në Athinë me shumë veprime të cilat përbëjnë përsëritje të të njëjtit veprim penal në një periudhë kohore të papërcaktuar, por në gjashtëmujorin e fundit e deri në arrestimin e tij, ai ka shitur sasi të paditur lënde narkotike, të paktën të një sasi 500 gram e llojit heroinë dhe 100 gram të llojit kokainë, kundrejt një çmimi të paditur apo transaksioni tjetër në persona të paditur.
4. Në Athinë më datë 24/01/1999 dhe rreth orës 01:15, i vendosur për kryerjen e krimin ai ka tentuar, akti i cili ka të paktën fillim kryerje, përkatësisht ka tentuar të shesë në sheshin Koliatsou dhe në rrugën [redacted] tek oficeri i policisë [redacted] sasinë prej 45 gram lëndë narkotike të llojit heroinë kundrejt shumës monetare prej 5000 dhrami grami, akt i cili nuk u realizua pasi e arrestuan oficerët e policisë.
5. Në Athinë në adresën rruga [redacted] sheshi Koliatsou dhe në periudhë kohore të papërcaktuar por në gjashtëmujorin e fundit e deri në arrestimin e tij ka poseduar, mbajtur sasi lënde narkotike të llojit heroinë dhe kokainë, të paktën në sasi të përmendura më lartë”. Rezulton se shtetasi [redacted] alias [redacted] është dënuar me vendimin nr. 100-101/2001 të Gjykatës së Përzier të Betuar në Athinë, për veprat penale të dëmtimeve të rrezikshme trupore dhe përdorim arme, duke e dënuar më 26 muaj burgim. Ndërsa me vendimin nr. 311726/2000 të Gjykatës së Shkallës së Parë Athinë është dënuar me 27 muaj burg për veprat penale vjedhje në vazhdimësi, betim i tremë si

dëshimtarë në vazhdimësi dhe për mashtrim. Këto të dhëna provohen nga aktet e administruara përmes letërporosisë nga autoritetet gjyqësore të Republikës së Greqisë. Ndërsa nga të dhënat policore rezultojnë se shtetasi [redacted] është dënuar më datë 07/05/2011 nga autoritetet gjyqësore greke për shkelje të ligjit mbi lojrat e fatit, si dhe po kryhen akoma hetime në lidhje me aktivitetin e tij kriminal në Greqi.

Në kuadër të hetimeve të këtij procedimi penal, është kryer hetim pasuror dhe financiar për subjektin [redacted] alias [redacted], i datëlindjes 17/06/1978 dhe familjarët e tij, duke administruar të dhënat nga të gjitha institucionet përkatëse, si Bankat e Nivelit të Dytë, Banka e Shqipërisë, etj. Nga të dhënat e administruara rezultojnë se shtetasit e mësipërm kanë nënshkruar kontratat e mëposhtme dhe disponojnë pasuritë e mëposhtme:

1. Kontrata e kaparit nr. 1239 rep dhe nr. 463 kol, datë 13/07/2005, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasve [redacted], në cilësinë e blerësit të ardhshëm. Përmes kësaj kontrate palët kanë rënë dakort që shtetasve [redacted] t'i shiten dy apartamente të tipit "A-7, A-8", shkalla e dytë, të përbërë nga "1+1", në katin e pestë nga toka dhe me sipërfaqe secili nga 77 m², kundrejt çmimit prej 70.000 Euro. E konventuar nga eksperti në lekë, rezultojnë se objektet e mësipërme janë blerë në shumën prej 8.610.000 lekë.

Përmes deklaratës noteriale nr. 1062 rep dhe nr. 920 kol, datë 05/08/2010, të nënshkruar ndërmjet shtetasve [redacted] dhe [redacted] është përshkruar fakti se: "Deklarojmë se pranë kësaj zyre noteriale kemi nënshkruar kontratë kapari për blerjen e një apartamenti banimi tip "A-7", të përbërë nga 1+1, në katin e tetë nga toka e banesës dhe me sipërfaqe totale 77 m², i pozicionuar në krahun perëndimor të banesës.

Sot më datë 05/08/2010 ne deklarojmë se z. [redacted] ka marrë vlerën prej 35.000 Euro që ka paguar për blerjen e apartamentit më sipër dhe e ka dorëzuar atë. Z. [redacted] deklaron se e ka marrë në dorëzim apartamentin dhe znj. [redacted] nuk ka asnjë detyrim përse i përket pagesës për apartamentin dhe dorëzimit të apartamentit".

2. Kontrata e kaparit nr. 1240 rep dhe nr. 464 kol, datë 13/07/2005, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasve [redacted], në cilësinë e blerësit të ardhshëm. Përmes kësaj kontrate palët kanë rënë dakort që shtetasve [redacted] t'i shiten prej shoqërisë ndërtuese [redacted] sh.p.k, një apartament i tipit "A-8", shkalla e dytë, i përbërë nga "1+1", në katin e katërt nga toka e banesës dhe me sipërfaqe 77 m², kundrejt çmimit prej 35.000 Euro.

E konventuar nga eksperti në lekë, rezultojnë se është blerë në shumën prej 4.305.000 lekë. Përmes deklaratës noteriale nr. 1546 rep dhe nr. 891 kol, datë 14/08/2007, shtetasja [redacted] ka deklaruar se më datën 14/08/2007 është likuajduar vlera totale e blerjes prej 35.000 Euro, si dhe ka marrë

apartamentin në dorëzim.

3. Kontrata e kaparit nr. 710 rep dhe nr. 393 kol, datë 11/05/2006, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasit [redacted] në cilësinë e blerësit të ardhshëm. Përmes kësaj kontrate është rënë dakort që shtetasja [redacted] të blejë dy dyqane, e konkretisht:

"1. Dyqani nr. 1, me sipërfaqe 48.8 m² + 7.4 m² verandë, i pozicionuar në krahun veri-lindor të banesës, në vlerën 65.000 Euro.

2. Dyqani nr. 4A, me sipërfaqe 17 m², i pozicionuar në krahun perëndimor të banesës, në shumën 20.000 Euro". E konventuar nga eksperti në lekë, rezulton se dyqanet janë blerë në shumën prej 10.455.000 lekë. Në kontratë është përcaktuar se më datën 11/05/2006 është paguar shuma prej 1.000 Euro, deri më datën 25/05/2006 do të paguhet shuma prej 14.000 Euro, deri më datën 25/01/2007 do të paguhet shuma prej 30.000 Euro, deri më datën 25/05/2007 do të paguhet shuma prej 20.000 Euro dhe në momentin e dorëzimit të dyqaneve do të paguhet shuma prej 20.000 Euro.

4. Kontrata e shitjes nr. 1239 rep dhe nr. 300 kol, datë 24/11/2014, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasve [redacted] e [redacted] në cilësinë e palës blerëse. Përmes kësaj kontrate shetaset [redacted] e [redacted] kanë blerë një apartament që ndodhet në Linzë, Tiranë, [redacted], me sipërfaqe 81.3 m², ZK 2460, me numër pasurie 192/43+3-14, vol 30, faqe 112, në shumën prej 45.120 Euro.

E konventuar nga eksperti në lekë, rezulton se është blerë në shumën prej 5.549.760 lekë. Në kontratë është përcaktuar fakti se shuma e çmimit është likuiduar totalisht nga pala blerëse sipas përcaktimit në kontratën nr. 3629 rep dhe nr. 1266 kol, datë 10/05/2006 të noteres [redacted]. Rezulton se në kontratën 3629 rep dhe nr. 1266 kol, datë 10/05/2006 është përcaktuar se kësti i parë në vlerën 18.200 Euro është paguar më datë 06/05/2006, kësti i dytë në vlerën 10.000 Euro paguhet më datë 15/07/2006, kësti i tretë në shumën 14.000 Euro paguhet më datë 15/07/2007 dhe kësti i katërt në vlerën 2920 euro paguhet me dhënien e çelësave në dorë të apartamentit.

5. Kontrata e shitblerjes nr. 1746 rep dhe nr. 1412 kol, datë 30/10/2008, e lidhur ndërmjet subjektit [redacted] sh.p.k, në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasit [redacted] në cilësinë e palës blerëse. Përmes kësaj kontrate shtetasi [redacted] ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe 104 m², që ndodhet në lagjen "Uji i Ftohtë", Vlorë, pjesë e kompleksit [redacted] apartament i cili është regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 22, datë 25/07/2008, me numër pasurie 2/1+1-14, ZK 8602, në shumën prej 8.112.000 Lekë. Në kontratë është përcaktuar fakti se shuma e çmimit është likuiduar plotësisht prej palës blerëse jashtë zyrës noteriale dhe apartamenti është marrë në dorëzim prej blerësit.

Përmes kontratës nr. 218 rep dhe nr. 214 kol, datë 10/03/2011, të lidhur

ndërmjet shtetasit [redacted] në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasve [redacted] dhe [redacted], në cilësinë e palës blerëse, rezulton se shtetasi [redacted] ka shitur apartamentin me numër pasurie 2/1+1-14, i regjistruar në regjistrin hipotekor nr. 501, datë 11/11/2008, në shumën prej 6.720.000 Lekë. Në kontratë është përshkruar fakti se shuma e plotë e çmimit është paguar jashtë zyrës noteriale.

6.. Nga të dhënat e administruara pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t Vlorë, rezulton se shtetasi [redacted] më datën 17/07/2006 ka paraqitur kërkesë për legalizim, të objektit banesë, me adresë Nartë, viti i ndërtimit 2005, me sipërfaqe ndërtimi 175 m² dhe me sipërfaqe të zënë 400 m². Nga vlerësimi i kryer prej ALUIZNI-t për pagesën e detyrimeve për legalizim, vlera e investimit është përlogaritur në shumën prej 6.387.384 lekë.

Ndërsa nga verifikimi në terren i objektit të ndërtuar ka rezultuar se objekti është me sipërfaqe 188 m², me një kat nën tokë dhe me një kat mbi tokë dhe me sipërfaqe të zënë 500 m². Referuar këqyrjes së këtij objekti rezulton se objekti është i papërfunduar dhe referuar fazës në të cilën ndodhen punimet, eksperti ka arritur në konkluzionin se punimet kanë përfunduar në masën 30%, që i korespondon shumës prej 1.916.215 lekë.

7..Nga administrimi i të dhënave pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Vlorë, rezulton se në emër të shtetasve [redacted] dhe [redacted] figuron i regjistruar mjeti i llojit "Renault", vit prodhimi 1998, me targa [redacted] i blerë në shumën prej 420.000 lekë.

8..Ndërsa referuar informacionit bankar rezulton se shtetasi [redacted] posedon më datën 12/07/2017 shumën prej 1.783.070 lekë në llogarinë bankare 0030377866 pranë Raiffeisen Bank. Po ashtu, rezulton se shtetasi [redacted] posedon më datën 04/08/2017 shumën prej 16.668 lekë në llogarinë bankare 408003882 pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

Pas administrimit të të dhënave në lidhje me pasuritë e shtetasit [redacted] dhe [redacted], i datëlindjes 17/06/1978 dhe familjarëve të tij, organi procedues ka vendosur kryerjen e ekspertimit kontabël. Bazuar në aktin e ekspertimit kontabël rezulton se shtetasi [redacted] dhe familjarët e tij posedojnë pasuri të paluajtshme në shumën prej 30.835.975 Lekë, një automjet në shumën prej 420.000 lekë, si dhe mjete monetare të konventuara në lekë në shumën prej 1.800.092 lekë.

Në përfundim është arritur në konkluzionin se pasuria e shtetasit [redacted] dhe familjarëve të tij është në vlerën prej 33.056.092 lekë, ndërsa të ardhurat e këtyre shtetasve ndër vite, nuk arrijnë vlerat mesatare të shpenzimeve për jetesë e si të tilla këto të ardhura nuk kanë shërbyer për blerjen apo krijimin e pasurive. Rezulton se eksperti ka konkluduar se shuma e parave në llogarinë bankare që daton që në vitin 1996, në emër të shtetasit [redacted], shumë e cila është 1.388.075 lekë, është pasuri e justifikuar. Mbi bazën e të dhënave të mësipërme eksperti ka konkluduar se shuma e pasurisë prej 33.110.017 lekë është pasuri nga burime të pidentifikuara dhe

të ligjshme të ardhurash.

Nga të dhënat e mësipërme rezultojnë se pasuria e paluajtshme e përfutur nga shtetasi [redacted] dhe familjarët e tij, dyshohet se ka si origjinë të ardhurat e përfutur nga shtetasi [redacted] nga aktiviteti kriminal i ushtruar prej tij në fushën e lëndëve narkotike në Greqi. Rezultojnë se ky shtetas është dënuar me vendimin nr. 2028/2003 të Gjykatës Pesë Anëtarëshe të Krimeve të Rënda Athinë, për veprën penale të blerjes, posedimit, magazinimit dhe shitjes së lëndës narkotike nga toksikoman, me 5 (pesë) vite burgim. Nga këto të dhëna ekzistojnë dyshime të arsyeshme se ndodhemi para konsumimit të elementëve të veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit pasuror të sekuestros preventive, të parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale, mbi pasurinë e paluajtshme dhe të luajtshme të përfutur nga shtetasi [redacted] dhe familjarët e tij, pasuri të cilat dyshohet se janë përfutur mbi bazën e të ardhurave të siguruar nga aktiviteti kriminal i ushtruar nga shtetasi [redacted] në fushën e lëndëve narkotike në shtetin grek.

Neni 17 Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se:

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka dikëuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut."

Neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon se:

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, trashëgim, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil."

Neni 1, Protokollin 1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, parashikon se:
"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga pronat e tij, veçse për arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare."

Neni 36 i Kodit Penal parashikon se:

1. Konfiskimi jepet detyrimisht nga gjykatat dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:
 - a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës

penale;
b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;
c) të shpërblimeve, të dhëna ose të premtuara, për kryerjen e veprës penale;
ç) të çdo pasurie tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale;

d) të sendeve, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i të cilave përbëjnë veprën penale, edhe kur nuk është dhënë vendim dënimi.

2. Nëse produktet e veprës penale janë transformuar ose shndërruar pjesërisht ose plotësisht në pasuri të tjera, këto të fundit i nënshtrohen konfiskimit.

3. Nëse produktet e veprës penale janë bashkuar me pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, këto të fundit konfiskohen deri në vlerën e produkteve të veprës penale.

4. Konfiskimit i nënshtrohen edhe të ardhurat ose përfitimet e tjera nga produktet e veprës penale, nga pasuritë në të cilat janë transformuar ose shndërruar produktet e veprës penale ose nga pasuritë me të cilat janë përzier këto produkte, në të njëjtën masë dhe mënyrë sikurse produktet e veprës penale."

Neni 274 i K.Pr.Penale parashikon se:

"1.Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron."

Neni 276 i K.Pr.Penale parashikon se:

"1.Kundër vendimit për vënien ose mosvënien e sekuestros cilido që ka interes mund të bëjë ankim.

2.Kërkesa e ankimit paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dhënia e vendimit ose nga dita që i interesuari ka marrë dijenë për sekuestron e vënë".

Në kuptim të nenit 36, paragrafi i parë, gërmat "b" dhe "ç" të Kodit Penal, përbën produkt të veprës penale dhe konfiskohet detyrimisht nga gjykata çdo lloj pasurie si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejt ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale, si dhe çdo pasuri tjetër, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale. Ndërsa në nenin 274/1 të K.Pr.Penale është sanksionuar se kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e Prokurorit, Gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

Ndërsa sipas paragrafit të dytë të kësaj dispozite procedurale penale rezulton se sekuestroja mundet që të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet sipas nenit 36 të Kodit Penal. Prandaj të gjitha këto rrethana e bëjnë të domosdoshme vendosjen e masës së sigurimit të sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të përfituara nga shtetasi [redacted] alias [redacted] dhe familjarët e tij, me qëllim që të mos rëndohen dhe të zgjasin pasojat e veprës penale.

Gjykata cmon se kërkesa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për caktimin e masës së sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive", mbi pasuritë objekt kërkesë, është e bazuar në prova dhe në ligj dhe do të pranohet.

Neni 274 i Kodit të Procedurës Penale parashikon:

- "1. Kur ka rrezik që disponimi i lire i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rendojë ose të zgjasë pasojat ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdheron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.*
- 2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.*
- 3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron".*

Në rastin objekt gjykimi, duke analizuar dispozitën e cituar më lart në raport me konkluzionet e hetimeve paraprake të deritanishme, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet dhe kriteret që lejojnë gjykatën të caktojë masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive", të parashikuar nga neni 274 i Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me natyrën juridike të sekuestros preventive.

Gjykata vlerëson se, nevojat e procedimit penal, përveç atyre lidhur me lirinë personale të individit, mund të kenë të bëjnë edhe me sendet, në masën që ato mund të prekin apo cenojnë funksionimin dhe mbarëvajtjen e procedimit penal; pra, kur prania e tyre mund të rëndojë, apo të zgjasë pasojat e saj, ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo kur behët fjalë për sende të rrezikshme e të ndaluara me ligj. Në këtë rast flitet për sekuestrimin si një instrument për realizimin e shtrëngimit pasuror, krahas atij personal që ka qëllime të ndryshme.

Procedura, modalitetet, si dhe kufizimet që parashikohen në procedimin mbi caktimin e masave të sigurimit pasuror nga ligji procedural penal, kanë të bëjnë me garantimin e lirive kushtetuese lidhur me pasurisë, siç janë e drejta e pronës, parashikuar nga neni 41/1 i Kushtetutës, si dhe liria e veprimtarisë ekonomike, parashikuar nga neni 11 i Kushtetutës, duke vënë në baraspeshim në vijë të drejtë interesin publik dhe mbrojtjen e shoqërisë nga veprimet kriminale, me të drejtat themelore kushtetuese të individit në raport me ndërhyrjet e shpërpjesëtuara dhe të papërligjura.

Gjykata vlerëon se, përmes vendimit mbi sekuestrimin e sendeve, autoriteti gjyqësor synon heqjen/bllokimin e një sendi/apo pasurie të përcaktuar, nga disponimi i lirë i një subjekti që e zotëron atë, duke i vendosur sendit një detyrim të caktuar, i cili mund të jetë me karakter të përkohshëm apo përfundimtar në rastin e veprimtarive të ndaluara me ligj.

Duke përdorur si kriter qëllimin që kërkohet të realizohet me anë të vendimit për sekuestrimin e sendit, në bazë të nevojave procedurale, ligji procedural penal parashikon tre kategori sekuestrimesh.

1. Sekuestrimi si një mjet për kërkimin e provës, sipas nenit 208 të KPP; pra sekuestrimi për qëllim mbledhjen e provave materiale, nuk përbën një masë sigurimi pasuror, madje është pikërisht qëllimi për sekuestrimin e provave elementare që dallon këtë institut, nga sekuestroja preventive dhe ajo konservative, të parashikuara nga ligji procedural si masa sigurimi pasuror.
2. Sekuestro konservative, e cila ka të bëjë me vendosjen e një detyrimi në sendet e luajtshme ose të paluajtshme të të pandehurit ose të shumëve a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre, të pandehurit apo të paditurit civil me qëllim pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, sipas neneve 270-273 të Kodit të Procedurës Penale.
3. Sekuestro preventive, në bazë të neneve 274-276 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet në rastin kur ekziston rreziku që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

Nisur nga sa sipër, gjykata vlerëson se, sekuestro preventive, si masë e sigurimit pasuror mund të vendoset vetëm kur plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte:

1. Kur ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se, sendi që kërkohet të sekuestrohet është produkt i një veprë penale (*fumus boni juris*).
2. Kur ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova, se disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, apo edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal (*periculum in mora*).

Sa i takon elementit të *fumus boni juris*, në bazë të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se për zbatimin e sekuestros preventive, është e nevojshme hetimi dhe marrja e të dhënave dëshmuuese rreth kryerjes (së mundshme në të ardhmen e afërt) së një fakti që përbën veprë penale të parashikuar dhe të cilësuar në bazë të një dispozite të Kodit Penal, si dhe verifikimi i faktit të një rëndimi, apo zgjatjeje të pasojës së veprës penale, apo të një lehtësimi të kryerjes së veprave të tjera penale, në raport me rrethanat dhe veçoritë e faktit konkret të supozuar se është kryer apo do të kryhet.

Sa i takon pranisë së elementit të *periculum in mora*, gjykata vlerëson se, ky element përbën vetë qëllimin e nevojshëm për caktimin e kësaj mase mbi pasurinë, pra në shmangien e ardhjes ose zgjatjes së pasojave nga vepra penale apo të lehtësimi të

kryerjes së veprave të tjera penale. Në këtë mënyrë, elementi i *periculum in mora*, nuk duhet të konsiderohet si një eventualitet i përgjithshëm e abstrakt, por si një probabilitet realist, që sendi objekt i mundshëm sekuestrimi preventiv, të bëhet shkak rëndues, zgjatës, për veprën penale të supozuar, apo shkak lehtësues për vepra të tjera të supozuara se mund të ndodhin efektivisht. Kjo mbështetur në llojin dhe natyrën e sendit dhe tërësinë e rrethanave konkrete, dhe duke u bazuar në nevoja reale dhe jo gjasa thjesht teorike.

Gjykata vlerëson se, se sekuestro preventive mund të urdhërohet për "qëllime të parandalimit" të pasojave apo veprimeve të paligjshme kriminale, në rastet e parashikuara prej pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në rastet e parashikuara prej pikës "2", të po këtij neni, sekuestroja preventive mund të urdhërohet për "qëllime të sekuestrimit", sipas përcaktimeve të parashikuara nga neni 36 i Kodit Penal. Në rastin e dytë, kemi të bëjmë me një "goditje" më efektive të avantazheve ekonomike që vijnë si rezultat i veprimtarive kriminale, dhe masa në fakt merr trajtën e një sanksioni penal.

Në lidhje me rrethin e sendeve, të cilat mund jenë objekt i sekuestrimit preventive, si masë e sigurimit pasuror, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin Nr.201, datë 09.12.2015, ka arritur në përfundimin se:

Objekti i sekuestrimit preventive përcaktohet shprehimisht në sendet që lidhen me veprën penale të supozuar se është kryer, prandaj nuk duhet lejuar caktimi i masës së sigurimit pasuror të sekuestrimit preventive përpara se të jetë kryer vepra penale, apo thjesht një shpjegim i normës penale abstrakte.

Për këtë arsye, është e nevojshme prania e një sërë indicjeve që lidhin sendin apo pasurinë me natyrën dhe llojin e veprës penale të supozuar nga ana e organit të akuzës në raport edhe me faktet e parashtruara apo të grumbulluara mbi çështjen konkrete.

Këto indicje nuk duhet të vlerësohen në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, por mbi baza aktuale dhe konkrete, mbështetur në të dhëna objektive që hedhin dritë mbi rëndimin, zgjatjen, apo kryerjen e të tjerave veprime kriminale, në raport me cenimin që i bëhet marrëdhënies juridike të mbrojtur nga norma penale. Gjithashtu, gjykata e themelit duhet të verifikojë dhe të argumentojë edhe mbi praninë e një sërë indicjeve që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se do të arrihet një vendim dënimi.

Objekti i sekuestrimit preventive, sipas pikës "1" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, përbëhet nga "sendet që lidhen me veprën penale", domethënë nga marrëdhënia e krijuar midis sendit dhe veprës penale të kryer, apo me të ardhurat që vijnë si rezultat i kryerjes së veprës penale, po të vazhdojë mbajtja e mëtejshme e sendit, raport i cili nuk është i rastësishëm, por i konceptuar dhe vënë në funksion të natyrës së veprës penale."

Gjykata vlerëson se, në rastin e pikës "2" të nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, objekti i sekuestrimit përbëhet nga sendet e sekuestrueshme, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal, por të qenit i sekuestrueshëm i sendit, nuk është kusht i vetëm për përligjen e masës së sigurimit pasuror të sekuestrimit preventive, pasi edhe në këtë rast, janë të nevojshme prania e dy këtyre elementëve.

1. Së pari, prania e elementit të *fumus commissis delicti*, domethënë që sendi duhet të ketë qenë ai që ka shërbyer apo ai i destinuar për kryerjen e veprës penale, apo se është pikërisht ai që përbën produktin e veprës penale, shpërblimeve, të dhëna, prodhimi, përdorimi, mbajtja ose tjetërsimi i së cilit,

- përbën veprën penale.
2. Së dyti, është e nevojshme vërtetimi i një lidhjeje të posaçme, funksionale dhe jo të rastësishme (domethënë të qëndrueshme) midis sendit dhe veprimit penal të kundërligjshëm.

Neni 287, pika 1, shkronja "b" e Kodit Penal¹, parashikon se:

"1. Pastrimi i produkteve të veprës penale i kryer nëpërmjet:

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave reale të tjera, që lidhen me pasurinë që është produkt i veprës penale;"

Gjykata vlerëson se, parashikimi i nenit 287, pika 1, shkronja "b" e Kodit Penal, është e njëjtë me parashikimin e nenit 9, pika 1, shkronja "b" të Konventës së Këshillit të Europës "Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit"².

Gjykata vlerëson se, ekzistenca e kësaj figure krimi, është shprehje e politikës penale të ligjëvendësimit, i cili nisur nga kushtet aktuale social ekonomike, formave të ndryshme të shfaqjes së kriminalitetit dhe ratifikimit të instrumentave ndërkombëtare si konventa e lartpërmendur, synon parandalimin dhe goditjen e fenomenit të pastrimit të produkteve të veprës penale.

Neni 1 i Konventës së Këshillit të Europës "Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit" jep këtë përkufizim: "Për qëllime të kësaj Konvente:

a) "produkt" nënkupton çdo avantazh ekonomik të nxjerrë nga veprat penale. Ky avantazh mund të konsistojë në çdo pasuri, siç përcaktohet në nënparagrafin b të këtij neni;

b) "pasuri" nënkupton pasuri të çdo natyre, fizike ose jofizike, e luajtshme ose e paluajtshme, si dhe aktet juridike ose dokumentet që vërtetojnë një titull ose interes mbi këtë pasuri;"

Nocionin e "produktit të veprës penale" e konstatojmë edhe në nenin 36 të Kodit Penal, i cili parashikon se:

"1. Konfiskimi jepet detyrësisht nga gjykata dhe ka të bëjë me marrjen dhe kalimin në favor të shtetit:

a) të sendeve që kanë shërbyer ose janë caktuar si mjete për kryerjen e veprës penale;

b) të produkteve të veprës penale, ku përfshihet çdo lloj pasurie, si dhe dokumentet ose instrumentet ligjore që vërtetojnë tituj ose interesa të tjerë në pasurinë që rrjedh ose fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga kryerja e veprës penale;"

Gjykata vlerëson se, parashikimi i nenit 36 të Kodit Penal në lidhje me nocionin e "produktit të veprës penale" është i ngjashëm me atë të nenit 1 të Konventës së

¹ Nga një interpretim literal dhe logjik të dispozitës, arrihet në përfundimin se, produktet të cilat synohen të pastrohen mund të vijnë si rezultat i kryerjes së një krimi apo edhe të një kundravajtje penale. Kjo sipas nenit 1 të Kodit Penal, ku parashikohet se: "Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale."

² Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr.9646, datë 27.11.2006 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen, dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit."

Këshillit të Europës "Për Pastrimin, Kërkimin, Kapjen dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin dhe Për Financimin e Terrorizmit", që do të thotë se, produkt të veprës penale, do të kuptojmë çdo avantazh ekonomik i nxjerrë nga një veprë penale, i cili mund të konsistojë në pasuri të çdo natyre si dhe në dokumenta apo akte juridike që vërtetojnë një titull apo një interes mbi këto pasuri.

Objekti juridik i kësaj veprë penale përfaqëson tërësinë e marrëdhënieve juridike të vendosura nga ligjvënësi me qëllim garantimin e funksionimit të rregullt dhe normal të organeve të administratës publike dhe mbrojtja e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale.

Objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që pastrohet.

Nga ana objektive, kjo veprë penale kryhet përmes veprimeve aktive të autorit të veprës, të cilat bien brenda parashikimeve të njëjës nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal.

Midis veprimeve të autorit të veprës penale (që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale) dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së pasojës (pastrimi i produktit të veprës penale), duhet të ekzistojë lidhje shkakësore, në kuptimin që realizimi i pastrimit të produktit të veprës penale (pasoja) të vijë ekskluzivisht dhe drejtpërdrejtë nga veprimet e autorit të veprës penale (shkaku).

Gjykata e çmon me rëndësi në këtë pikë, të evidentojë faktin se midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (*condicio sine qua non*).

Nga ana subjektive vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale, kryhet vetëm me dashje direkte³, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron ardhjen e pasojës (pastrimin e produktit të veprës penale), pra ai ka dijeni se pasuria apo avantazhi ekonomik (shih më sipër përkufizimin) i ardhur nga vepra penale mëmë, përbën produkt të veprës penale dhe dëshiron që këtë produkt ta pastrojë përmes veprimeve aktive të realizuara në njërin nga format e parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal.

Qëllimi është element cilësues i dispozitës konkrete dhe ai konsiston në:

- (i). Fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë ose dhënien e ndihmës, për të shmangur pasojat juridike, që lidhen me kryerjen e veprës penale.
- (ii). Shmangien nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave.

Pra, autori i veprës penale, veprimtarinë e tij kriminale e kryen duke e ditur që avantazhet apo pasuria që ai disponon janë produkt i veprës penale dhe synon t'i pastrojë ato, duke i dhënë trajtën e një pasurie apo avantazhi ekonomik të ligjshëm.

Gjykata çmon se, pastrimi i produkteve të veprës penale nuk përfaqëson një akt të vetëm, por përfshin një proces, i cili synon jo vetëm fshehjen e origjinës së vetë produktit, por edhe mbajtjen nën kontroll të tij dhe ky proces, zakonisht kalon nëpër tre faza, të cilat janë:

³ Neni 15 i Kodit Penal.

1. Vendosja e produktit të veprës penale;
2. Shtresëzimi, i cili përfaqëson përpjekjen e autorit të veprës penale për të realizuar ndarjen e produktit nga burimi kriminal, duke krijuar rrjete komplekse transaksionesh financiare;
3. Integrimi, i cili përfaqëson epilogun e procesit të pastrimit të produkteve të veprës penale, në të cilin ky produkt (zakonisht para) integrohet në ekonominë e ligjshme dhe bashkohet me asetet e tjera të ligjshme, duke e bërë mjaft të vështirë ndarjen midis pasurisë së ligjshme dhe asaj të paligjshme.

Ndërkohë, nga ana subjektive, ajo kryhet vetëm me dashje direkte, në kuptimin që, autori i veprës penale e parashikon dhe e dëshiron falsifikimin apo përdorimin e dokumentit të falsifikuar, pra ka dijeni rreth falsitetit të dokumentit që vë në përdorim.⁴

Neni 149 i Kodit të Procedurës Penale, në të cilin specifikohet se:

“Prova janë njoftimet mbi faktet e rrethanat që lidhen me veprën penale, që merren prej burimeve të parashikuara në ligjin procedural penal, në përputhje me rregullat e caktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat e ardhura prej saj, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.”

Neni 150 i K.Pr.Penale, parashikon se:

“Janë objekt prove faktet që kanë lidhje me akuzën, fajësinë e të pandehurit, caktimin e masave të sigurimit, dënimin dhe përgjegjësinë civile, si dhe faktet nga të cilat varet zbatimi i normave procedurale.”

Për sa mësipër çmojmë se pasuritë e mësipërme janë produkt i veprës penale dhe veprimtarisë kriminale të ushtruar nga shtetasi Jorgo Xhaxho alias Klodian Xhaxho në fushën e lëndëve narkotike në shtetin grek, e për rrjedhojë krijohen dyshime se disponimi i këtyre pasurive mundet që të rëndojë apo të zgjasë më tepër pasojat e veprës penale apo mundet që të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera penale, si dhe është një pasuri që duhet të konfiskohet.

Perfundimisht, gjykata do të pranojë kërkesën e paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlore duke vendosur mbi pasuritë e paluajtshme objekt kerkimi, masen e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive”, të parashikuar nga neni 274 i Kodit të Procedurës Penale.

PER KETO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 274 275, 276 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

VENDOSI

⁴ Vendimi Nr.113, datë 27.03.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Vendimi Nr.186, datë 05.06.2013 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

1. Pranimi i kërkeses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për caktim të masës së sigurimit pasurore të sekuestros preventive të parashikuar nga neni 274 të K.Pr.Penale, në kuadër të procedimit penal nr. 1042 të vitit 2017, mbi pasuritë e mëposhtme:

- Të pasurisë së paluajtshme apartament tipi A-8, në katin e pestë nga toka dhe me sipërfaqe 77 m², e blerë nga shtetasja [redacted] përmes kontratës së kaparit nr. 1239 rep dhe nr. 463 kol, datë 13/07/2005, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [redacted], në cilësinë e blerësit të ardhshëm, apartament i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga subjekti [redacted] sh.p.k, në lagjen "10 Korriku", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.

- Të pasurisë së paluajtshme apartament tipi A-8, shkalla e dytë, i përbërë nga "1+1", në katin e katërt nga toka e banesës dhe me sipërfaqe 77 m², i blerë nga shtetasja [redacted] përmes kontratës së kaparit nr. 1240 rep dhe nr. 464 kol, datë 13/07/2005, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [redacted], në cilësinë e blerësit të ardhshëm, apartament i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga subjekti [redacted] sh.p.k, në lagjen "[redacted]", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.

- Të pasurisë së paluajtshme dyqani nr. 1, me sipërfaqe 48.8 m² + 7.4 m² verandë, i pozicionuar në krahun veri-lindor të banesës, i blerë nga shtetasja [redacted] përmes kontratës së kaparit nr. 710 rep dhe nr. 393 kol, datë 11/05/2006, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [redacted], në cilësinë e blerësit të ardhshëm, dyqan i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga subjekti [redacted] sh.p.k, në lagjen "[redacted]", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.

- Të pasurisë së paluajtshme dyqan nr. 4A, me sipërfaqe 17 m², i pozicionuar në krahun perëndimor të banesës, i blerë nga shtetasja [redacted] përmes kontratës së kaparit nr. 710 rep dhe nr. 393 kol, datë 11/05/2006, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e shitësit të ardhshëm dhe shtetasës [redacted], në cilësinë e blerësit të ardhshëm, dyqan i cili ndodhet në objektin e ndërtuar nga subjekti [redacted] sh.p.k, në lagjen "10 Korriku", Vlorë, sipas lejes së ndërtimit të dhënë me vendimin nr. 4/35, datë 19/04/2005 të KRRT-së së Bashkisë Vlorë.

- Të pasurisë së paluajtshme apartament që ndodhet në [redacted] me sipërfaqe 81.3 m², ZK 2460, me numër pasurie 192/43+3-14, vol 30, faqe 112, i blerë nga shtetasit [redacted] e [redacted], përmes kontratës së shitjes nr. 1239 rep dhe nr. 300 kol, datë 24/11/2014, e lidhur ndërmjet shoqërisë [redacted] sh.p.k, në cilësinë e palës shitëse dhe shtetasve [redacted] në cilësinë e palës blerëse.

- Të pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe ndërtimi 175 m² dhe me sipërfaqe të zënë 400 m², të deklaruar për legalizim më datën 17/07/2006 nga shtetasi [REDAKTUAR]

- Të pasurisë së luajtshme e llojit automjet tip "[REDAKTUAR]" vit prodhimi 1998, me targë [REDAKTUAR] i regjistruar në emër të shtetasve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR]

- Të shumës prej 1.783.070 lekë lekë, të depozituara në Raiffeisen Bank, në llogarinë nr. 0030377866, në emër të shtetasit [REDAKTUAR]

2. Urdhërohen Oficeret e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë si dhe A.SH.K.Vlorë për ekzekutimin e këtij vendimi për ekzekutimin e këtij vendimi.
- 3.
4. Kunder vendimit lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 10 diteve nga e nesërmbja e shpalljes. Për palet e interesuara afati i ankimit fillon nga e nesërmbja e marrjes dijeni.

U shpall në Vlorë, sot me datë 24.10.2020

SEKRETARE
DOLORES ZEMANAJ

GJYQITARE
HERILA ÇELA